



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.311-4/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim Anr.307-4/2025, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, të parashtruar kundër vendimeve të PZAP-it Anr.311/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR kërkesa Anr.307-4/2025 datë 09.02.2025, e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimit të PZAP-it, Anr.311/2025 datë 05.02.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjorbë në lartësi prej 3.000.00 Euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.311/2025 datë 05.02.2025, subjektit ankues i ka shqiptuar dënim me gjorbë në lartësi prej 3.000.00 Euro, në emër të të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

PZAP-i, me datë 09.02.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.311/2025, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, lidhur me peretendimet e kandidatit Shaban Osmanaj si kundërpërgjigje në ankesë duhet administruar seriozisht sepse vendi ku i njëjti ka vizituar sheh Përparimin nuk është objekt fetar, dhe e dyta tarikati apo bashkësia e tyre nuk njihet nga shteti e as kushtetuta e Kosovës, dhe ka propozuar që vendimet e lartcekura të anulohen tërësisht, apo pjesërisht pas rishikimit të tyre.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit A.nr.311/2025 të datës 05.02.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës kërkesës Anr.307-4/2025 të datës 09.02.2025, për rishqyrtimin e vendimit konstatohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se PZAP-i pas shqyrtimit të kërkesës erdhi në përfundim se për vendimin A.nr.311/2025 të datës 05.02.2025 nuk kemi të bëjmë me prezentimin e fakteve të reja, dhe është konstatuar nga ana e PZAP-it se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik LDK Shaban Osmanaj në postimin e datës 02.02.2025 në llogarinë e tij të facebook-ut me qëllim të përfitimit të votave ka bërë fushatë me përfaqësues fetar (SHEH) në fshatin Planejë e Hasit.

Në nenin 118 paragrafi 4 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se : *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Në rastin konkret subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kërkesën për rishikim të vendimit A.nr.311/2025 datë 05.02.2025 nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bind panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.311-4/2025 datë 13.02.2025



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.